



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.42, datë 14.12.2022

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“OBJEKT BANIMI DHE SHËRBIME ME 21 KATE MBITOKË DHE 4 KATE PARKIM  
NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “DERVISH HIMA”, BASHKIA  
TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Gener 2” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Objekt banimi dhe shërbime me 21 kate mbitokë dhe 4 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në rrugën “Dervish Hima”, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërorinë “Gener 2” sh.p.k.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, datë 20.06.2018, nuk ndryshon.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

